

PKR.nr. 148/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA– Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nën.par.1.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.511/2014 të dt.21.03.2016, pas mbajtës së shqyrtimit fillestar verbal e publik, në prezencën e të akuzuarit A. M., prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari, përfaqësuesi i KQZ-së Xhemajl Peqani, me dt. 08.02.2017 publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

A. M. nga i ati Sh., e ëma A. e gjinisë B., i lindur me dt: *data e lindjes...*, në f.sh.M., lagjja “....., K-P., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer 5 klasë të shkollës fillore, jo i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal: *numër personal....*

ËSHTË FAJTORË

SEPSE: Me rastin e votimit për zgjedhjet lokale, me datën 03.11.2013, në fsh. M. komuna e P., në shkollën fillore “...” ne vendvotimin me numër 1969e/01d, ka keqpërdor të drejtën e tij të votimit; voton me kusht edhe ose me parë kishte votuar në mënyrë të rregullt, ashtu që më rastin e verifikimit të fletë votimeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është vërtetuar se i njëjti ka votuar dy here dhe të pandehurit i është refuzuar vota me kusht.

- me këtë ka kryer veprën Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nën.par.1.1 të KPK-së

-Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,4,41,42,49,51,52,73,450 të KPRK-së dhe nenit 365, 450 dhe 463 të KPPRK-së.

Të akuzuarin A. M.

Për veprën penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nën.par.1.1 të KPK-së, i shqiptoi **DENIM ME KUSHT-DENIM BURGU** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në periudhë kohore prej **1 (një) viti**.

Kërkesës pasurore-juridike, nuk pati.

I akuzuari A. M. obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **30 € (tridhjetë)**, në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.511/2014 të dt.21.03.2016, kundër të akuzuarit A. M. për shkak të veprës penale Keqpërdorim i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 nën.par.1.1 të KPK-së. Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 05.02.2014 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për s'çarime shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPK-së deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPK-së dhe duke aplikuar mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës GJ.A.nr.207/2013 të dt.19.03.2013, ku kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqyrtimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim dhe pa e plotësuar trupin gjykues.

Gjykata pa fjalë përfundimtare pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë vazhdoi me shqyrtimin e dënimit duke marr parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e veta dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimi, kushtet e vështira ekonomike, faktin se i njëjti është mbajtës i familjes. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti.

Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbej si preventivë individuale dhe gjeneralë dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike gjykata e morri konform nenit 463 par.1 të KPPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.148/16, të dt. 08.02.2017**

**Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

KESHILLË JURIDIKE: Prokurori i shtetit dhe i akuzuari hoqën dorë nga e drejta në ankesë.